

IPKO
Robert ERZIN
Drejtör
Prishtinë

Ankesa Nr. 2016/216 KPM vs IPKO
Ref:1708/804/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2016/216 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër IPKO
("Pala Përgjegjëse")**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 5 gusht 2008. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve të cilët, pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
3. KPM, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të kësaj Rregulloreje nga ana e operatorëve të shpërndarjes, ka iniciuar monitorim specifik për disa aspekte të caktuara që konsiderohen si obligime të reja dhe shtesë që dalin nga Rregullorja KPM-2016/01.
4. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 13 tetor 2016, ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka vendosur një sistem/opsion për ri-renditjen e kanaleve (katalogut të kanaleve) sipas kërkesës së klientit siç obligohet me nenin 16, paragrafi 3 të Rregullores KPM-2016/01.
5. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 4 nëntor 2016 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljen e bërë dhe i ka kërkuar që në afat prej pesë (5) ditësh të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01. Po ashtu, në Njoftim është paralajmëruar që dështimi për të ardhur në pajtueshmëri do ta shtyjë KPM-në të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra.

6. KPM me datën 10 nëntor 2016 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës pohon se Pala Përgjegjëse mundëson ri-renditjen e kanaleve nëpërmes krijimit të listës favorite.
7. KPM ka bërë monitorim të dytë të Palës Përgjegjëse në lidhje me ri-renditjen e kanaleve dhe ka gjetur se një gjë e tillë ende nuk është e mundur. Pala Përgjegjëse mundëson vetëm krijimin e një liste favorite e cila e ruan logjikën e renditjes së kanaleve nga numri një deri në fund. KPM ka komunikuar edhe një herë me Palën Përgjegjëse, me datën 15 nëntor 2016, duke ia argumentuar se pranuesi të cilin e posedon KPM nuk e mundëson ri-renditjen e kanaleve dhe duke ju kërkuar sqarime shtesë.
8. KPM me datën 23 dhjetor 2016 i ka dërguar Palës Përgjegjëse edhe një shkresë, duke e njoftuar se nuk kishte pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse pas kërkesës për sqarime shtesë. Po ashtu, KPM me atë shkresë i ka kërkuar Palës Përgjegjëse që në afat prej dhjetë (10) ditësh të ndërmarrë veprime konkrete për të ardhur në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren KPM-2016/01, ose se në të kundërtën do të iniciohet procedurë ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
9. KPM, me datën 30 dhjetor 2016 ka pranuar një përgjigje të dytë nga Pala Përgjegjëse, në të cilën shpjegohet mënyra se si të krijohet lista favorite dhe ofruan mundësinë e takimit me teknikët e tyre për sqarime shtesë.
10. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 8 mars 2017 ka gjetur se edhe pas një monitorimi të po asaj date, Pala Përgjegjëse nuk e mundëson ri-renditjen e kanaleve.
11. KPM me datën 13 mars 2017 ka pritur në një takim përfaqësuesit e Palës Përgjegjëse, ku tekniku i tyre është munduar që të demonstrojë mundësinë e ri-renditjes së kanaleve. Por, edhe në atë takim KPM ia ka bërë me dije Palës Përgjegjëse se ajo çfarë ata e quajnë ri-renditje nuk është ajo që kërkohet me Rregulloren KPM-2016/01.
12. KPM me datën 17 mars 2017 ka pranuar edhe një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, në të cilën edhe një herë pretendojnë se e mundësojnë ri-renditjen e kanaleve dhe na njoftojnë se nuk pajtohen me interpretimin e nenit me të cilin rregullohet ri-renditja e kanaleve.

Analiza Ligjore

13. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 16, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 16, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të sigurojë që përdoruesi të ketë mundësinë të bëjë ri-programimin e renditjes numerike të programeve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon, njësoj sikurse edhe të drejtën e grupimit të programeve apo edhe “kontrollit prindëror” duke filluar pas kanalit informues e deri tek kanali i fundit në kuadër të pakos programore.”


14. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse pretendon se e mundëson ri-renditjen e kanaleve sipas kërkesës së klientit, duke ua mundësuar atyre krijimin e një liste të re favorite, si grupim të programeve. KPM, pas analizimit të fakteve, gjendjes aktuale dhe duke u bazuar në nenin 16, paragrafi 3, ka gjetur se ky nen përfshin tri detyrime të operatorëve të shpërndarjes: 1) ri-programimin e renditjes numerike të programeve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon 2) të drejtën e grupimit të programeve, dhe 3) "kontrollin prindëror". Me këtë rast, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse mundëson krijimin e grupimit të programeve dhe kontrollin prindëror, por jo edhe ri-renditjen e kanaleve të platformës së tyre, për të ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2016/01.
15. KPM, ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për shkelje, shkresave dhe takimit të mbajtur, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 16, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01, duke mos e mundësuar ri-renditjen e kanaleve.

Vendimi

16. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 16, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.
17. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 16, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.
18. Komisioni kërkon nga Pala Përgjegjëse që nga data 1 janar 2018, të mundësojë ri-renditjen e kanaleve, në mënyrë që të veprojë në pajtim me nenin 16, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

E drejta për Ankesë

19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar



26.08.2017

Datë